



## **VENDIM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT**

**Data e miratimit: 29 shkurt 2016**

**Numri i lëndës: 2012-22**

**Desanka dhe Zoran Stanisic**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 29 shkurt 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. VENDIMI I PANELIT I DATËS 11 NËNTOR 2015**

1. Më 11 nëntor 2015, Paneli ka marrë vendim në lidhje me ankesën e paraqitur nga ankuesi kundër EULEX-it dhe i ka dhënë një sërë rekomandimesh shefit

të Misionit (ShM) në përputhje me rregullën 34 të rregullores së punës. Në pjesët përkatëse në vendim thuhet:

#### “PANELI, NJËZËRI

1. *Shpall* ankesat sipas nenit 3 të Konventës të papranueshme pasi qartazi janë të pabazuara;
2. *Konstaton* se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës;
3. *Gjen* një shkelje të nenit 13 të Konventës;
4. *Konstaton* se nuk është e nevojshme për të shqyrtuar çështjen sipas nenit 14 të Konventës.

dhe

#### DEKLARON

se në bazë të gjetjeve të mësipërme të fakteve dhe ligjit, Paneli gjen të përshtatshme që të bëjë rekomandime për ShM-në, dhe

#### REKOMANDON VEPRIMET E MËPOSHTME KORRIGJUESE

- a. ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë një shkelje të të drejtave të ankuesve që i ngarkohen veprimeve [dhe/ose mosveprimeve] të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv;
  - b. ShM-ja duhet t'i ofroj një kopje të këtij vendimi prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse. Kjo duhet të shërbej që të informohen prokurorët e EULEX-it rreth natyrës së përgjithshme të detyrimit të tyre për t'i përfshirë viktimat në hetimet e tyre dhe për të ofruar arsye të duhura rreth ndërprerjes së ndonjë hetimi në ndonjë rast të veçantë.”
2. Vendimi i tanishëm është vendim pasues i vendimit të Panelit të datës 11 nëntor 2015 dhe rekomandimeve të bëra në të.
  3. Kompetencat dhe autoriteti i Panelit për t'i përcjell vendimet dhe rekomandimet e tij është e dhënë në rregullën 45 e tutje të rregullores së punës (shih p.sh. vendimet mbi zbatimin e rekomandimeve [W kundër EULEX-it](#), 2011-07, 26 gusht 2014; [Becic kundër EULEX-it](#), 2013-03, 11 nëntor 2015).

## **II. INFORMACIONI I MARRË NGA SHEFI I MISIONIT TË EULEX-IT LIDHUR ME ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT**

4. Më 15 dhjetor 2015, ShM ka njoftuar Panelin rreth masave që ai i kishte marrë në këtë rast si përgjigje ndaj rekomandimeve të Panelit.
5. ShM-ja ka shprehur zyrtarisht keqardhjen e tij për faktin se ankuesit nuk ishin të përfshirë mjaftueshëm në procedurat hetimore dhe se atyre nuk ju ishin dhënë arsyet për përfundimin e hetimeve.
6. Në lidhje me rekomandimin e dytë të Panelit, ShM-ja ka treguar se vendimi i Panelit i datës 15 nëntor 2015 ju ishte shpërndarë prokurorëve të EULEX-it nga ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të EULEX-it. Në veçanti, prokurorët e EULEX-it ishin përkujtuar se në vendimet për pushimin e kallëzimeve penale duhet të përfshihet “një përmbledhje të shkurtër të arsyeve rreth vendimit”. Për më tepër, nevoja dhe arsyeshmëria e intervistimit të personin që e ka dorëzuar kallëzimin penal duhet të vlerësohet në çdo rast para se të lëshohet vendimi që të pushohet kallëzimi penal.

## **III. VLERËSIMI NGA PANELI**

7. Paneli vëren hapat e ndërmarrë nga ShM-ja për të zbatuar rekomandimet e tij.
8. Paneli vëren se rekomandimi i tij i parë ishte për ShM-në që të bënte një deklaratë se pranon që rrethanat e rastit përbënin shkelje të të drejtave të ankuesve që i ngarkojnë Misionit gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Në letrën e tij të datës 15 dhjetor 2015, shefi i Misionit ka shprehur keqardhjen e tij se ankuesit nuk ishin të përfshirë sa duhej në procesin e hetimit dhe se atyre nuk ju ishin dhënë arsye të mjaftueshme për përfundimin e këtij procesi. Përderisa një përgjigje e tillë nuk përfshinë plotësisht rekomandimin e Panelit, keqardhja e shprehur nga shefi i Misionit përbën pranim të mangësive në procesin hetimor që në njëfarë mënyre shkon drejt asaj që ankuesve t'i ofrohen mjete juridike për shkeljen të drejtave të tyre.
9. Në vendimin e tij të datës 15 nëntor 2015, Paneli gjithashtu rekomandoj që ShM-ja duhet t'i ofroj kopjet e atij vendimi prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse. Në letrën e tij, ShM-ja ka treguar se vendimi i Panelit në me të vërtetë ju ishte shpërndarë prokurorëve të EULEX-it nga ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të EULEX-it. ShM-ja më tej ka treguar se prokurorëve të EULEX-it ju ishin përkujtuar detyrimet e tyre për të ofruar një përmbledhje të shkurtër të arsyeve të tyre atëherë kur e hedhin poshtë kallëzimin penal dhe arsyeshmëria e intervistimit të personin që ka parashtruar kallëzimin penal duhet të vlerësohet në çdo rast. Paneli është i bindur se këto hapa janë konsistente dhe plotësisht në përputhje me rekomandimin e dhënë nga Paneli në këtë pikë.

10. Pas shqyrtimit të informacionit të dhënë nga ShM-ja lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Panelit,

### **PANELI NJËZËRI**

*Deklaron* se ShM-ja ka zbatuar shumicën e rekomandimeve të Panelit.

*Vendos* të mbyllur shqyrtimin e kësaj lëndë.

Për Panelin,

Joanna MARSZALIK  
Zyrtare ligjore



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese